



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____

V E N D I M

Nr. 51, Datë 21.04.2021,

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSPEKTORATIN SHTETËROR TË MJEDISIT,
PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT TIRANË
“MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”,
për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2019.**

Nga auditimi i ushtruar në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë rezultoi që, veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të institucionit për procedurat e inspektimit, administrimin e mallrave të sekuestruar, të aktivitetit ekonomiko-financiar, nuk ka qenë plotësisht efektive, si rrjedhojë e mangësive në zbatimin e procedurave në përputhje me kuadrin ligjor.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi auditimin e përputhshmërisë së aktivitetit në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë”, sipas programit të auditimit nr.190/1 prot., datë 18.02.2020, ndryshuar me shkresën nr.190/3 prot., datë 20.05.2020, si dhe autorizimit 190/34 datë 29.03.2021 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2019.

II. Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I KUALIFIKUAR/CILËSUAR

KLSH ka audituar veprimtarinë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, për periudhën 2017-2019 në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ISSAI 4000¹, për vlerësimin nëse aktiviteti i ISHMPUT-së është kryer duke respektuar dhe zbatuar, ligjet, rregulloret në fuqi, marrëveshjet, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet/investimet vjetore të buxhetit, kryerjen e inspektimeve, zbatimin e kuadrit ligjor për vendosjen e penaliteteve, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre.

Baza për opinionin e kualifikuar/ cilësuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë:

-Nga auditimi i përdorimit të karburantit sipas levizjeve të kryera nga Kryeinspektori dhe inspektorët me mjetet e punës (makinat) u konstatuan parregullsi në administrimin dhe përdorimin e karburantit, në vlerë prej 2,039,490 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.30. datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, konkretisht të urdhër-shpenzimeve nr.158, datë 26.12.2018, dhe nr.114, datë 17.07.2019, për likuidimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit “Pashaporta Dixhitale Mjedisore”, janë konstatuar parregullsi në plotësinë e dokumentacionit justifikues për kryerjen e këtyre shpenzimeve, dhe në gjykimin e grupit të auditimit është shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 9,496,000 lekë.

- Në 22 raste nga auditimi i praktikave të inspektimit në DRISHMPUT Korçë janë konstatuar veprime/mosveprime, si mospasqyrimi i llojit të shkeljes dhe sasisë së drurit të transportuar në mënyrë të paligjshme, në procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes, në vendimin përfundimtar të inspektimit, nuk jepet masa për sekuestrimin e lëndës drusore të transportuar në mënyrë të paligjshme, nuk është mbajtur procesverbali i llogaritjes së dëmit të shkaktuar në ekonominë pyjore, dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 40,795,000 lekë.

-Nga auditimi janë konstatuar parregullsi në zbatimin e dispozitave të prokurimit publik; mosrespektim të kuadrit ligjor për kryerjen e inspektimeve, vendosjen e penaliteteve, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre, si dhe dobësi në zbatimin e buxhetit, etj., si më poshtë vijon:

-Për vitin 2018-2019, ISHMPUT nuk ka hartuar raportet monitorimit të zbatimit të buxhetit, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në nenin 65 “Monitorimi”.

-Për periudhën 2017 - 2019, ka pasur strukturë të paqëndrueshme inspektorësh, karakterizuar me ndërprerje të shpeshta, si dhe në 70% të rasteve janë kryer emërimet pa u mbështetur në respektim kriteresh të përcaktuara, pa pasur një dokument të përgatitur dhe miratuar, lidhur me kërkesat specifike për arsimin e inspektorëve dhe me kërkesat specifike për çdo vend pune në ISHMP, të miratuara nga Inspektorati Qendror”.

-Operatorët ekonomik nuk kanë përmbushur kushtet e kontratës dhe termat e referencës së projektit, duke mos dorëzuar pranë ISHMPUT 100 tabletat elektronike, si dhe nga Autoriteti Kontraktor nuk është bërë zgjidhja e kontratës në zbatim të nenit 23 të saj, duke krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit me efekt dëm ekonomik në vlerën 9,219,600 lekë.

-Nga shqyrtimi i aktiveve/veprimeve, si s’kualifikimi në mënyrë të padrejtë ofertën ekonomike, dorëzimi i draft-raportit përfundimtar 20 ditë me vonesë, mosvendosjen e penaliteteve për vonesën dhe mosdorëzimin e 100 tabletave elektronike, dokumentacionit të administruar në dosjen e tenderit “Pashaporta dixhitale mjedisore”, grupi i auditimit konstaton se nga veprimet dhe mosveprimet e Autoritetit Kontraktor, janë përdorur jo në

¹ **ISSAI 4000** – Referuar ISSAI 4000, (paragrafi 191 dhe 200-201), audituesit e sektorit publik kanë detyrimin të komunikojnë konkluzionet e angazhimit në raportin e auditimit. Konkluzioni mund të shprehet si një opinion, përfundim dhe përgjigje për pyetjen ose rekomandimet specifike të auditimit.

përputhje me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës 33,470,330 lekë.

-Situata e mësipërme është konstatuar edhe në 6 raste nga auditimi i praktikave të inspektimit në Degën rajonale ISHMPUT Shkodër dhe Lezhë, ku si pasojë janë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 2,031,500 lekë. Veprimet/mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, për sekuestrimin e drurëve, bimëve të ekonomisë pyjore dhe administrimin e tyre.

- Për vitin 2017 nuk janë dokumentuar dhe administruar në magazinë 358 m³ dru zjarri të sekuestruara, përkatësisht nga IPP Korçë 274 m³ (sipas shkresave IPP Korçë nr. 200 dhe 200/1 datë 05.04.2018) dhe IPP Lezhë për 84 m³, në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr.10.296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe me shkresën nr. 6931, datë 12.06.2014 të Ministrisë Mjedisit, që bën fjalë “Për depozitimin, ruajtjen, shitjen e materialit drusor të sekuestruar nga ISHMPU”.

-Për vitin 2017, janë administruar pranë protokollit të ish-ISHMPUT qendër rreth 260 ankesa në total të bëra nga subjekte publike dhe private, prej të cilave janë shqyrtuar vetëm **133 prej tyre**, ose **51.1 %**, si dhe nga 133 ankesat e shqyrtuara, në 23 prej tyre nuk është respektuar afati i shqyrtimit të tyre brenda 30 ditëve në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 1, neni 140 të Ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

-Në 7 raste, komisioni i ankimeve të ISHMPUT Tiranë ka aplikuar 2 standarte, pasi për shkelje të njëjta disa subjekteve u ka shfuqizuar gjobën, në vlerën 5,135,000 lekë gjithsej, ndërsa për disa tjera e ka lënë në fuqi.

- Në 13 raste nga auditimi i praktikave të inspektimit të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Standardeve në Turizëm, ndaj subjekteve (stacione plazhi), janë konstatuar veprime/mosveprime, si mosvendosja e gjobave në rastin e konstatimit të shkeljeve nga grupi i inspektorëve, mosaplikimi i penaliteteve ndaj subjekteve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacionin brenda afatit të kërkuar, duke penguar kryerjen e inspektimit, dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **1,591,800 lekë gjithsej**.

-Në 5 raste nga auditimi i praktikave të inspektimit të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Standardeve në Turizëm, ndaj agjencive dhe operatorëve turistik, janë konstatuar veprime/mosveprime të ngjashme si në praktikat e inspektimit të stacioneve të plazhit, dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **670,000 lekë gjithsej**. Veprimet/mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar; Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; VKM nr.171, datë 27.03.2019 “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

-Për vitin 2017-2018, sektori i inspektimit të pyjeve në qendër, ish-DRISHMPUT Korçë, Shkodër dhe Lezhë, si dhe Drejtoria e Mbikqyrjes së Standardeve në Turizëm, për vitin 2019, nuk kanë hartuar, programin vjetor të inspektimit, por e kanë kryer këtë funksion në mënyrë rastësore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24, Kreu IV në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pikën 2.2 dhe 2.7, Kreu II të Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH”, pikën 4 dhe 5 të Kreut I të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve”.

Opinion i cilësuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së ISHMPUT²

² Sipas Rregullore së Procedurave të Auditimit dhe Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, Kapitulli VII “Raportimi në Auditimin e Përputhshmërisë”, Opinion i cilësuar (jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e majftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuar, të cilat janë materiale, por jo të

Sipas opinionin tonë, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, aktiviteti i kryer nga ISHMPUT për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, kryerjen e inspektimeve, vendosjen e penaliteteve, administrimin dhe ndjekjen e procesit të arkëtimit të gjobave, shqyrtimin e ankesave, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre, nuk ka qenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në fushën e mjedisit, për procedurat e prokurimit publik, kundërvajtjet administrative dhe rregulloret respektive, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

Theksojmë se kemi arritur në këtë opinion auditimi, për arsye se institucioni, është ristrukturuar prej një periudhe rreth 6 muajsh, si dhe një pjesë e konsiderueshme e stafit të këtij institucioni janë larguar nga detyra, ç'ka e ka bërë të pamundur sigurimin e evidencës së mjaftueshme, për dhënien e një opinionit me siguri të arsyeshme. Gjithashtu evidenca audituese e grumbulluar, nuk ka qenë e mjaftueshme, për arsye se Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve pranë ISHMPUT Qendër, nuk na ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e kërkuar (dosjet e inspektimit të pyjeve, lëndën drusore të sekuestruar si dhe administrimin e saj), si dhe një pjesë e stafit ishin larguar nga detyra, prej të cilëve do të sigurohej dokumentacioni i plotë.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017 dhe 2018, sektori i inspektimit të pyjeve në qendër, ish-DR ISHMPUT Korçë, Shkodër dhe Lezhë, si dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm, për vitin 2019 nuk kanë hartuar programin vjetor të inspektimit, por e kanë kryer këtë funksion në mënyrë rastësore, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 24, Kreu IV në Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pikën 2.2 dhe 2.7, Kreu II të Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH”, pikën 4 dhe 5 të Kreut I të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet 87-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve në Turizëm, si dhe AKM dhe AKB, të cilave nëpërmjet ristrukturimit, u është shtuar edhe funksioni i inspektimit, të marrin masat e nevojshme, që për çdo vit, ta hartojnë dhe miratojnë programet vjetore dhe mujore të inspektimit për fushat përkatëse të aktivitetit të tyre, duke respektuar kërkesat ligjore në përmbajtjen informacionit të tyre dhe afatet e përgatitjes dhe miratimit.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në ISHMPUT për vitin 2017 deri në fund të vitit 2019 rezulton se janë vendosur gjithsej **1564 gjoba** në vlerë totale 654,118,000 lekë, nga të cilat janë likuiduar vetëm 211 gjoba në vlerën **40,637,392 lekë**, si dhe janë pa arkëtuar 1353 gjoba në vlerën **613,480,608 lekë**, duke mos ndjekur procedurat ligjore sipas Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 9, shkronja b pika 4 të nenit 30, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe Rregulloren e brendshme me nr.2 datë 18.07.2016, pikën 204 të Kreut VII. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 55-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marri masat e nevojshme për identifikimin, vlerësimin, arkëtimin, duke konsideruar edhe afatin e parashkrimit, të **1353** gjobave në vlerën në vlerën **613,480,608 lekë**, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat si në AKM, AKB dhe Drejtoritë Rajonale deri në procese gjyqësore.

Brenda vitit 2021

përhapura, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura)

3.Gjetje nga auditimi: Në 22 raste nga auditimi i praktikave të inspektimit në DRISHMPUT Korçë janë konstatuar veprime/mosveprime, si mospasqyrimi i llojit të shkeljes dhe sasisë së drurit të transportuar në mënyrë të paligjshme, në procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes, në vendimin përfundimtar të inspektimit, nuk jepet masa për sekuestrimin e lëndës drusore të transportuar në mënyrë të paligjshme, nuk është mbajtur procesverbali i llogaritjes së dëmit të shkaktuar në ekonominë pyjore, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 1 të nenin 40/1 të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, të ndryshuar; nenin 27, pikën 3 të nenit 45 të Ligjit Nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; si dhe pikën 34 dhe 35, shkronja b të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, për sekuestrimin e drurëve, bimëve të ekonomisë pyjore dhe administrimin e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet 64-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Nisur nga ristruktimi i ish-ISHMPUT, ku Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve në qendër dhe rajone, kaloi në Varësi të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (institucion i krijuar me VKM nr.570, datë 17.07.2019), i rekomandojmë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për njoftimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, me qëllim që nga inspektorët e këtij institucioni, për çdo rast të konstatimit të shkeljeve në ekonominë pyjore, dëmtimet e florës dhe faunës, të mbahet procesverbali i përlllogaritjes së dëmit të shkaktuar. Gjithashtu për çdo material të sekuestruar (dru, bimë, armë gjahu, etj.) të mbahet procesverbali i marrjes në dorëzim nga inspektorët, fletë-hyrja në magazinën e institucionit, si dhe fletë-dalja në institucionet që kanë në administrim ekonominë pyjore.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në ISHMPUT për vitin 2017 deri në fund të vitit 2019 rezulton se janë furnizuar me blloqe inspektimi, proces verbale vendimore në sasinë 406 copë në total degët rajonale dhe Inspektorati Qendror, dhe janë shpërndarë 52 blloqe dhe 23 “pa dorëzuar”, të cilat nuk administrohen në magazinën e Inspektoratit Qendror në degët Rajonale, Shkodër (nga 50 blloqe të marrë në dorëzim, 12 prej tyre nuk janë dorëzuar), Korçë (nga 35 blloqe janë pa dorëzuar 11 blloqe), pasi procedurat ndiqen sipas sistemit online nga Gushti i vitit 2018, dhe blloqet duhej të dorëzoheshin në magazinë, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr.1497, datë 19.11.2008 “Për shtypjen e letrave me vlerë”, me ndryshime, pasi këto dokumente konsiderohen letra me vlerë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 55-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Nisur nga ristruktimi i ish-ISHMPUT³, i cili u nda në 3 institucione Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (në vijim AKM)⁴, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (në vijim AKP) dhe Inspektoratin e Mbrojtjes së Teritorrit (në vijim IMT), i rekomandojmë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme, duke njoftuar institucionet e mësipërme, me qëllim analizimin prej tyre të situatës së krijuar dhe nxjerrjen e përgjegjësisë, për dorëzimin e blloqeve të inspektimit, konstatimit dhe vendimit.

Brenda vitit 2021

5. Gjetje nga auditimi: Në ISHMPUT në vitin 2017 janë vendosur **160** gjoba në vlerën **54,730,000 lekë**, të cilat nuk janë të dokumentuara dhe kontabilizuar dhe nuk kanë ndjekur procedurat ligjore sipas neni 45, 46 të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011, Rregulloren me nr.2 datë 18.07.2016 “Kreut VII të Rregullores së brendshme” dhe në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 9, shkronja b pika 4 të nenit 30, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe Ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 55-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

³ VKM nr.570, datë 17.07.2019
⁴ VKM nr.568, datë 17.7.2019

5.1. Rekomandimi: ISHMPUT të marri masat e nevojshme për identifikimin, vlerësimin, arkëtimin, duke konsideruar edhe afatin e parashkrimit, të **160** gjobave në vlerën **54,730,000 lekë**, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat si në AKM, AKB dhe Drejtoritë Rajonale deri në procese gjyqësore.

Brenda vitit 2021

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e mara në DRISHMPUT Korçë rezulton se në 19 raste të inspektimi ndaj subjekteve janë vendosur gjoba në vlerën 1,520,000 lekë gjithsej, duke përdorur dy standarde, për të njëjtën shkelje ligjore (ku për të njëjtën shkelje janë aplikuar gjoba të ndryshme në vlerë, ose për të njëjtën shkelje nga dy subjekte, nuk është vendosur gjobë për të dy subjektet, por vetëm për njërin), në kundërshtim me kërkesat e Ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” si dhe Kreut VI, neni 45, 46, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet 79-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Nisur nga ristruktimi i ish-ISHMPUT, ku Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve në qendër dhe rajone, kaloi në Varësi të AKP (institucion i krijuar me VKM nr.570, datë 17.07.2019), i rekomandojmë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme për njoftimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, me qëllim, analizimin nga AKP, të situatës së krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, që praktika të tilla të trajtimit me dy standarde të subjekteve, për të njëjtën shkelje, të mos përsëriten në të ardhmen.

Brenda vitit 2021

7. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste, komisioni i ankimimeve i ISHMPUT Tiranë ka aplikuar dy standarde, pasi për shkelje të njëjta disa subjekteve u ka shfuqizuar gjobën, ndërsa për disa tjera ka lënë në fuqi gjobën, për vitin 2017-2018-2019, konkretisht janë shfuqizuar gjoba në vlerën 5,135,000 lekë, dhe janë lënë në fuqi gjoba në vlerën 250,000 lekë, veprimet të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pika 1 dhe 2, neni 17 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe pikën 1, shkronja a, të nenit 29, të Ligjit nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet 79-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Nisur nga ristruktimi i ish-ISHMPUT⁵, i cili u nda në 3 institucione AKM⁶, AKP dhe IMT, i rekomandojmë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme, duke njoftuar institucionet e mësipërme, me qëllim rishqyrtimin e të gjitha vendimeve të padrejta sipas përkatësisë, duke kërkuar arkëtimin e detyrimeve.

Brenda vitit 2021

8. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste, nga Kryeinspektori i ISHMPUT, janë shfuqizuar padrejtësisht vendimet, në kundërshtim me votimin e komisionit të ankimimit, pasi ky komision nuk ka votuar në mënyrë kolegjiale heqjen e gjobave, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 2 të nenit 51 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si vijon: me vendimin nr. 1299 datë 29.03.2018 ka shfuqizuar vendimin nr. 2 datë 07.08.2018, për “pezullim aktiviteti + 500,000 lekë gjobë”, për mungesë leje mjedisore ndaj subjektit “G.G” Vlorë; me vendimin nr. 1297 datë 29.03.2018 ka shfuqizuar padrejtësisht vendim-dënimin Fier nr.110 datë 15.08.2017 me 300,000 lekë gjobë ndaj N.D, pasi ky komision prej 4 veta nuk e ka votuar shfuqizimin, si dhe vendimin nr. 2 datë 11.07.2017 për dënimin me vlerë 500,000 lekë gjobë ndaj Al-M. Elbasan, pasi komisioni nuk ka votuar shfuqizimin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet 79-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: Nisur nga ristruktimi i ish-ISHMPUT⁷, i cili u nda në 3 institucione AKM⁸, AKP dhe IMT, i rekomandojmë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat e nevojshme, duke njoftuar institucionet e mësipërme, me qëllim rishqyrtimin lënien në fuqi të

⁵ VKM nr.570, datë 17.07.2019

⁶ VKM nr.568, datë 17.7.2019

të gjitha vendimeve të shfuqizuara në mënyrë të padrejtë, si dhe marrjen e masave të nevojshme duke kërkuar arkëtimin e detyrimeve.

Brenda vitit 2021

9. Gjetje nga auditimi: Komisioni i ankimimeve në 4 raste ka tejkalluar afatet ligjore 30 ditore për shqyrtimin e ankimimeve, si dhe në 2 raste ka lejuar ankesën e subjektit jashtë afatit 30 ditor, në kundërshtim me nenin 8/a të VKM nr. 103 datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionit të Inspektoratit shtetëror të mjedisit dhe pyjeve”, me nenin 46 të ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me pikën 1 neni 132 të ligjit 45/2015 “Kodi Procedurës Administrative” dhe me nenin 8 të Rregullores nr. 1 datë 24.07.2019 të ISHMPUT. Gjithashtu për vitin 2017, janë administruar pranë protokollit të ish-ISHMPUT qendër rreth 260 ankesa në total të bëra nga subjekte publike dhe private, prej të cilave janë shqyrtuar vetëm 133 prej tyre, ose 51.1 %, si dhe nga 133 ankesat e shqyrtuara, në 23 prej tyre nuk është respektuar afati i shqyrtimit të tyre brenda 30 ditëve në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 1, neni 140 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet 79-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Nisur nga ristruktimi i ish-ISHMPUT⁹, i cili u nda në 3 institucione AKM¹⁰, AKP dhe IMT, i rekomandojmë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të njoftoi institucionet e mësipërme, me qëllim marrjen e masave prej tyre, për funksionimin e plotë dhe në mënyrë të pandërprerë të komisioneve të shqyrtimit të ankesave, protokollimin e ankesave të mbërritura pranë institucioneve të tyre, si dhe shqyrtimin brenda afatit ligjor.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: ISHMPUT Tiranë nuk ka planifikuar në buxhet fonde për vendimet gjyqësore për punojësit e larguar nga puna, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 66/1 të Ligjit nr.252/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 12-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1.Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të marre masa dhe të planifikojë në buxhetin e ardhshëm vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna që kanë marrë vendime të formës së prerë.

Brenda vitit 2021

11. Gjetje: Komisionet në fillim të veprimtarisë së procesit të inventarizimit, nuk kanë hartuar akt-rakordim për të përcaktuar dhe fiksuar, numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes të fundit, nuk kanë përgatitur raportin informues për të paraqitur te Titullari i njësisë shpenzuese, informacionin mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve. Gjithashtu nga komisioni i inventarizimit nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, propozimin për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve, etj në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 83, 85, 86 të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 19-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1.Rekomandim: Nisur nga ristruktimi i ish-ISHMPUT¹¹, i cili u nda në 3 institucione AKM¹², AKP, i rekomandojmë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të njoftoi institucionet e mësipërme, me qëllim marrjen e masave prej tyre, që Komisionet e inventarizimit, në çdo rast të fiksohet nr.rendor i fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve para fillimit të inventarizimit dhe në përfundim të inventarizimit, të hartohet raporti i informacionit mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve.

Në vijimësi

⁹VKM nr.570, datë 17.07.2019

¹⁰ VKM nr.568, datë 17.7.2019

¹¹VKM nr.570, datë 17.07.2019

¹² VKM nr.568, datë 17.7.2019

12. Gjetje nga auditimi: ISHMPUT nuk ka kryer inventarizimin e llogarisë 215 “Mjete transporti”, janë mbajtur vetëm procesverbale marrje në dorëzim mbi gjendjen fizike, nuk kanë hapur kartela përkatëse për çdo mjet ku të jenë firmosur nga personat që i kanë në përdorim, veprime në kundërshtim me pikën 26, 60 dhe 73 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti e Sektorit Publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 19-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të marrë masa dhe të ngrihen komisione përkatëse për inventarizimin e llogarisë 215 “Mjete transport”, dhe hapjen e kartelave për çdo mjet.

Brenda vitit 2021

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit përkatës për periudhën 2018-2019, u konstatua se ditarët e veprimeve kontabël nuk mbaheshin sipas kërkesave të VKM nr. 248 datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël” i ndryshuar, udhëzimit nr. 14 datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare standardeve”, nuk është kryer kontabilizimi i fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve, si dhe përcaktimit ligjor të bërë në pikën 26 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësiti e Sektorit Publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 19-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Specialistja e financës të marrë masat për të çelur ditarët kontabël të magazinave dhe të pasqyrojë veprimet ekonomike sistematikisht dhe në kronologji.

Brenda vitit 2021

14. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2017-2019, ka pasur strukturë të paqëndrueshme inspektorësh, karakterizuar me ndërprerje të shpeshta, si dhe në 70% të rasteve janë kryer emërimet pa u mbështetur në respektim kriteresh të përcaktuara, pa pasur një dokument të përgatitur dhe miratuar, lidhur me kërkesat specifike për arsimin e inspektorëve dhe me kërkesat specifike për çdo vend pune në ISHMP, të miratuara nga Inspektorati Qendror, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Kreun V, pika 2, të VKM nr.103, datë 4.2.2015 “Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”, të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 19-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet AKM dhe AKB, të marri masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, kërkesat për kualifikimin profesional për çdo pozicion pune.

Brenda viti 2021

15. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017 nga IPP Korçë nuk janë dokumentuar dhe administruar në magazinë 274 m³ dru zjarri të sekuestruara, sipas shkresave IPP Korçë nr. 200 dhe 200/1 datë 5.04.2018), në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësiti e sektorit publik”, me ligjin nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, me VKM 248, datë 10.04.1998 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësiti që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” si dhe me shkresën nr. 6931, datë 12.06.2014 të Ministrisë Mjedisit, që bën fjalë “Për depozitimin, ruajtjen, shitjen e materialit drusor të sekuestruar nga ISHMPU”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet 55-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1. Rekomandimi: Titullari i MTM të marri masat e nevojshme për analizimin e situatës së krijuar, nxjerrjen e përgjegjësive, për administrimin e 274 m³ dru zjarri të sekuestruara për vitin 2017 nga ish-DR ISHMPUT Korçë, duke i bërë hyrje dhe dalje.

-Drejtoria Rajonale Mjedisit Lezhë ku bën pjesë ish-DR e ISHMPUT Lezhë të bëjë hyrje dhe dalje 84 m³ dru zjarri të sekuestruara për vitin 2017.

Brenda vitit 2021

16.Gjetje nga auditimi: ish-ISHMPUT (aktualisht AKM¹³ dhe AKP¹⁴) nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut të subjekteve që do të inspektohen, me qëllim përcaktimin e subjekteve që kanë risk më të lartë dhe frekuencën e inspektimit gjatë një viti, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Kap., I, pika 1.5 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të IQ nr. 13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu nuk është hartuar rregullorja e metodologjisë së përcaktimit të dënimeve, në fushën e inspektimit, në kundërshtim me pikën 8, neni 48 të Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqet 87-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, të cilave nëpërmjet ristrukturimit, u është shtuar edhe funksioni i inspektimit, të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e metodologjisë së llogaritjes së riskut të subjekteve që do të inspektohen, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit të funksionit të inspektimit. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregullores, që përcakton metodologjinë, për përcaktimin e llojit të dënimit, vlerën e masës së gjobës, në varësi të llojit të shkeljes dhe frekuencës së përsëritjes së saj.

Brenda vitit 2021

C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë administrative dhe ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit të krijuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **21,180,090 lekë**, si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Operatorët ekonomik nuk kanë përmbushur kushtet e kontratës dhe termat e referencës së projektit, duke mos dorëzuar pranë ISHMPUT 100 tabletat elektronike, si dhe nga Autoriteti Kontraktor nuk është bërë zgjidhja e kontratës në zbatim të nenit 23 të saj, duke bërë sekuestro të garancisë në masën 10% të vlerës së kontratës për zhvillimin e sistemit, në vlerën 9,219,600 lekë, dhe për pasoj janë krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit me efekt dëm ekonomik në vlerën 9,219,600 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 45-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marri masat e nevojshme për arkëtimin në buxhetin e shtetit, të garancisë 10% të kontratës, në vlerën 9,219,600 lekë nga subjekti privat B.“F” SHPK dhe “S.” SHPK, si pasojë e moszbatimit të kushtit të kontratës, për dorëzimin e 100 tableteve elektronike të porositura nga Autoriteti Kontraktor.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës nga ISHMPUT, për shërbimin e mirëmbajtjes të “Pasaportës Dixhitale”, u konstatuan pagesa në vlerë 9,496,000 lekë, ndaj subjektit “S.S.” SHPK, pasi janë kryer pagesa për shërbime të pa realizuara dhe padokumentuara, në kundërshtim me pikën 14, 18, 19, 20, 21, 26, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimit nr.30 datë 30.11.2012, “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar pika 2, 35 germa b, jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës së buxhetit të shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 45-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marri masat e nevojshme, duke ndjekur procedurat ligjore dhe shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 9,496,000 lekë,

¹³ VKM nr.568, datë 17.7.2019

¹⁴ VKM nr.570, datë 17.07.2019

pagesa të kryera ndaj “S.S.” SHPK, referuar kontratës nr.1346, datë 17.03.2017 për shërbimin e mirëmbajtjes, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, si pasojë e likuidimit të shërbimeve të pa kryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përdorimit të karburantit sipas lëvizjeve të kryera nga Kryeinspektori dhe inspektorët me mjetet e punës (makinat) u konstatua se karburanti në vlerën 2,039,490 lekë, është përdorur dhe nxjerrë nga magazina e institucionit pa u shoqëruar me dokumentacion vërtetues dhe justifikues, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 34, 35, 36 dhe 38 të Udhëzimit nr.30. date 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorin Publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 19-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur procedurat ligjore dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej **2,039,490 lekë**, nga punonjësit përgjegjës përfituar padrejtësisht dhe pa dokumentacion plotësues dhe ligjore.

-A. L 1,904,750 lekë,

-B.K. 33,000 lekë,

-I.M. 55,740 lekë,

-J.M. 46,000 lekë ,

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të dietave në ISHMPUT, është konstatuar se janë kryer pagesa të pa justifikuara në vlerën 425,000 lekë, ku kryesisht mungojnë faturat tatimore të hotelit, nënshkrimi i punonjësit që ka kryer shërbimin, etj., në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 35 dhe pika 36 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e bëra në shkronjën b, pika 3, Kreu III, dhe Kreu IV, të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet 19-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur procedurat ligjore dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej 370,000 lekë, nga punonjësit si vijon:

1- I. K. 16,500 lekë

2-A.B. 34,000 lekë

3-F.H. 11,000 lekë

4-F.S. 22,000 lekë

5-D.A. 22,000 lekë

6-F. K. 12,000 lekë

7-E. A. 12,000 lekë

8-H.T. 24,000 lekë

Menjëherë

C.2. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1.Gjetje nga auditimi: Në 22 raste nga auditimi i praktikave të inspektimit në DRISHMPUT Korçë janë konstatuar veprime/mosveprime si mospasqyrimi i llojit të shkeljes dhe sasisë së drurit të transportuar në mënyrë të paligjshme, në procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes, në vendimin përfundimtar të inspektimit, nuk jepet masa për sekuestrimin e lëndës drusore të transportuar në mënyrë të paligjshme, nuk është mbajtur procesverbali i llogaritjes së dëmit të shkaktuar në ekonominë pyjore, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 1 të nenin 40/1 të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për shërbimin pyjor”, të ndryshuar; nenin 27, pikën 3 të nenit 45 të Ligjit Nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; si dhe pikën 34 dhe 35, shkronja b të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, për sekuestrimin e drurëve, bimëve të ekonomisë pyjore dhe

administrimin e tyre, duke krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **40,795,000 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet 64-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

